**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**DHOMA E NOTEREVE TIRANE**
**NR. 1178 REP.**
**NR. 426 KOL.**

**MARREVESHJE PENGU**

*(mbi kuotat e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar)*

Sot me date 08/06/. 2015 (dymije e pesembedhjete) para meje noterit/noteres F. Koci, anetar/e ne Dhomen e Noterise Tirane, me zyre ne adresen: Rr. S. Frasheri, Tirane, u paraqiten personalisht per te redaktuar kete kontrate palet:

**KOLATERALMARRES:**

**BANKA KOMBETARE TREGTARE Sh.a** - Dega Sauk regjistruar ne Gjykaten e Tiranes me Vendimin nr.17469, dt. 23.07.1997, qe ketu e me poshte do te quhet **"Banka"**, perfaqesuar nga:

1. **Z. Fatjon Xhavit Hoxha,** i dtl. 10.07.1981, shtetas Shqiptar, mbajtes i dokumentit te identifikimit karte identiteti me Nr 0000031657 me detyre **Drejtues i Deges se BKT Sauk**, dhe

2. **Zj.Egesta Baki Caushi,** e datelindjes01.01.1984, shtetase Shqiptare, mbajtese e dokumentit te identifikimit: pasaporte me nr.025868732, ne cilesine e **Zv. Drejtuese ne Degen BKT-se Sauk.**

**KOLATERALDHENES:**

**"STRAVAJ ENERGY" Sh.p.k.**, regjistruar ne QKR me **date 23.06.2011** me **Numer Unik Identifikimi (NIPT) L11823001A**, me zyre qendrore te shoqerise ne adresen ne "Ndertese 3 kateshe (pallat) prane qendres se banuar "Stravaj" Komuna Stravaj, Librazhd *e cila perfaqesohet nga Ortaku i Vetem* ***"Edonil Konstruksion" Sh.p.k.****, regjistruar ne Qendren Kombetare te Regjistrimit (QKR) me* ***date 17.03.2001*** *me* ***Numer Unik Identifikimi (NIPT) K11519006K****, me seli ne adresen ne, Rruga: "Teodor Keko",pallati i ri i firmes Bogova, kati 2, Unaza e re, Kashar, Tirane,* e perfaqesuar ne nenshkrim nga ***Agron Skender Meçe,*** i datelindjes **22.09.1962,** shtetas **Shqiptar**, mbajtes i dokumentit te identifikimit: karte identiteti me Nr 027418328, dhe Nr. Personal G20922404C banues ne ______, Tirane, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar.

**Neni 1: Baza ligjore dhe perkufizime**

1.1 Kjo Marreveshje i nenshtrohet legjislacionit shqiptar ne pergjithesi duke perfshire rregullimin e posacem te parashikuar ne Kodin Civil ne nenet 530 deri 540 dhe nenet 546 deri 559.

**Neni 2: Objekti**

2.1 Me nenshkrimin e kesaj Marreveshje dhe sipas kushteve te percaktuara ne te, Kolateraldhenesi, me vullnet te shprehur te Aksionarit te Vetem Edonil Konstruksion" Sh.p.k. ne Vendimin e Asamblese te dates 08/06/2015, vendos peng ne favor te Kolateralmarresit te gjithe kuotat, qe perfaqesojne 100% te kapitalit te shoqerise "Stravaj Energy" Shpk., si dhe te gjitha te drejtat dhe pretendimet lidhur me to ("Kuotat" ose "Kolaterali") me qellim sigurimin e çdo dhe te gjithe detyrimeve te Shoqerise qe rrjedhin nga Kontrata e Kredise Nr. 1175 Rep., Nr. 423 Kol., date 08/06/ 2015, *(notere* F. Koci*)*, te lidhur me Banken Kombetare Tregtare Sh.a – Dega Sauk, per kredine shtese ne shumen totale 80,000,000 (tetedhjete milion) Leke, duke perfshire por pa u limituar ne interesat, penalitetet dhe cdo shpenzim te kryer nga Kredimarresi per te permbushur ekzekutimin ne menyre te detyrueshme ("Kontrata e Kredise").

2.2 Kjo Marreveshje dhe Kolaterali i dhene peng garanton per:
- pagesen ne kohe ose ekzekutimin e plote ne kohen e duhur, qofte me maturim te caktuar, me kerkese per

- parapagim, me deklarim, me pershpejtim, me kerkim ose menyra te tjera, te te gjitha detyrimeve qe tani dhe me pas ekzistojne ose rrjedhin prej ose ne lidhje me Kontraten e Kredise;
- permbushjen siç duhet te te gjitha detyrimeve, te tanishme dhe/ose te ardhshme, absolute ose te mundshme, direkte ose indirekte, perfshire te gjitha taksat, shpenzimet, demshperblimet ose edhe te tjera, perfshire edhe shpenzimet ligjore dhe tarifat e çdo lloji, dhe te gjitha detyrimet e çdo lloj natyre apo te nenkuptuar, ne çfaredo monedhe, per te cilen Kredimarresi dhe/ose Kolateraldhenesi eshte tani apo mund ne çfaredo kohe dhe here pas here te jete pergjegjes ndaj Kolateralmarresit sipas ose ne lidhje me Kontraten e Kredise.

2.3 Per te evituar çdo paqartesi, Kolateralmarresi nuk merr nepermjet kesaj Marreveshje asnje pergjegjesi apo detyrim qe rendon mbi Kolateraldhenesin apo ortakun e tij dhe keta te fundit jane pergjegjes per permbushjen e detyrimeve te percaktuara ne ligjin e zbatueshem, statutin e Shoqerise apo akte te tjera qe jane te detyrueshme per Kolateraldhenesin dhe ortakun e tij.

2.4 Nepermjet kesaj Marreveshje Kolateraldhenesi me vullnet te Ortakut te tij te vetem, autorizon Kolateralmarresin dhe i transferon Kolateralmarresit, ne menyre te parevokueshme dhe te pakushtezuar, secilen dhe te gjitha prej te drejtave te meposhtme qe do te ushtrohen veçmas nga ortaku i Kolateraldhenesit:

(i) te drejten per te kerkuar ndaj Shoqerise, arketuar dhe mbajtur pagesen e te gjithe dividendit/fitimit nga Kuotat si dhe çdo pretendim tjeter te Kolateraldhenesit qe lind nga ose ne lidhje me Kuotat, duke perfshire, pa u kufizuar, pretendime per pagesa bazuar ne zvogelimet e kapitalit ose pretendime per pagesa te kontributeve shtese dhe, nese ka, te ardhura nga likuidimi;

(ii) te drejten per te kerkuar, arketuar dhe mbajtur te ardhurat e realizuara nga shitja e Kuotave per efekte te ekzekutimit te Kontrates se Kredise dhe te kesaj Marreveshjeje deri ne shlyerjen e detyrimeve sipas Kontrates se Kredise.

**Neni 3: Te drejtat dhe detyrimet e paleve**

3.1. Kolateraldhenesi ka rene dakord qe pengu mbi **Kuotat** do te jete ne fuqi gjate gjithe periudhes se ekzistences se detyrimit qe rrjedh nga dhe sipas **Kontrates se Kredise**.

3.2. Kolateraldhenesi do te kryeje cdo veprim me ose pa kerkese te Kolateralmarresit per te ruajtur pengun mbi Kuotat nga veprimet sekuestruese te personave te trete si edhe prioritetin dhe te drejtat e Kolateralmarresit mbi to.

3.3. Kolateraldhenesi merr persiper qe te regjistroje pengun mbi Kuotat sipas kesaj Marreveshje (i) ne Regjistrin e Kuotave/Ortakeve si dhe (ii) ne Regjistrin Tregtar prane Qendres Kombetare te Regjistrimit. Kolateraldhenesi do te vere ne dispozicion te Kolatéralmarresit vertetimet perkatese per regjistrimin e pengut mbi Kuotat siç kerkohet me lart. Paraqitja e ketyre vertetimeve ne permbajtjen dhe formen qe konsiderohet e duhur nga Kolateralmarresi eshte kusht per disbursimin e kredise sipas Kontrates se Kredise.

3.4. Palet bien dakord qe pagesa e te ardhurave te permendura ne nenin 2.4 (i) me lart do te behet vetem ne llogarine e kredise se Kolateraldhenesit, i cili nuk ka dhe nuk do te kete asnje pretendim lidhur me ndonje pagese interesi per arketimet ne llogarine bankare te Kolateralmarresit.
Kolateralmarresi do te njoftoje Kolateraldhenesin per çdo arketim shumash te kryer ne kete llogari. Shumat e arketuara do te mbahen ne kete llogari bankare, perveç rastit kur ato perdoren siç percaktohet ne nenin 3.5 me poshte, deri ne momentin e permbushjes se te gjitha detyrimeve te Kredimarresit kundrejt Kolateralmarresit sipas Kontrates se Kredise perfshire çdo principal, kamatevonese, gjobe etj. Shuma e mbetur (nese ka te tille) pas shlyerjes se detyrimeve sipas Kontrates se Kredise do te kalohet brenda [2 (dy)] ditesh pune ne llogarine bankare te Kolateraldhenesit, perveçse kur palet bien dakord ndryshe me shkrim.

3.5. Kolateralmarresi ka te drejte te perdore shumat e paguara sipas kesaj Marreveshje (referuar pikes 2.4) per shlyerjen e detyrimeve te pagueshme te Kredimarresit ne baze te Kontrates se Kredise se siguruar nga kjo Marreveshje.

3.6. Kolateraldhenesi dhe Ortaku i tij do te kryeje te gjitha veprimet e nevojshme me qellim gezimin dhe ushtrimin efektiv te te drejtave te Kolateralmarresit sipas kesaj Marreveshje, siç i kerkohen vecanerisht nga Kolateralmarresi dhe/ose Shoqeria ne menyre te arsyeshme.

3.7. Kolateralmarresi dhe Kolateraldhenesi / Ortaku i tij bien dakord qe e drejta e votes qe rrjedh nga Kuotat do te ushtrohet nga Kolateraldhenesi me kusht qe vendimi apo vendimet (i) te jene konsistente me kete Marreveshje dhe Kontraten e Kredise, (ii) te mos prekin ne menyre negative vlefshmerine apo ekzekutueshmerine e pengut te krijuar sipas kesaj Marreveshje, (iii) te mos vijne ne kundershtim me Kontraten e Kredise, (iv) te mos pengojne ushtrimin e te drejtave te Kolateralmarresit sipas kesaj Marreveshje, (vi) te mos i zvogelojne vleren Kolateralit. Ne veçanti, Kolateraldhenesi nuk do te marre asnje vendim apo veprim dhe siguron qe as Shoqeria nuk do te ndermarre ndonje vendim apo veprim qe kane per qellim apo efekt likuidimin, ndarjen, bashkimin, zvogelimin e kapitalit, shnderrimin apo ristrikturime te tjera te biznesit te Shoqerise qofte teresisht apo pjeserisht, si dhe te mos ngarkoje Shoqerine me detyrime te cilat do te kishin per efekt zvogelimin e vleres se Kolateralit pa miratimin paraprak me shkrim te Kolateralmarresit. Gjithashtu, Kolateraldhenesi do te njoftoje menjehere Kolateralmarresin mbi te gjitha pretendimet e paleve te treta te cilat kane per efekt ose do te kishin per efekt zvogelimin e vleres se Kolateralit.

3.8. Kolateraldhenesi dhe Ortaku i tij bien dakord qe nuk do te behet asnje transferim i kuotave te shoqerise koncensionare kundrejt nje pale tjeter pa miratim me shkrim nga Banka. Ne rast konstatimi te shkeljes se ketij kushti, Kolateraldhenesi dhe Ortaku i tij pranojne pa asnje kontesim se do te aplikohet parashikimi i nenit 14. 1(f) te Kontrates se Kredise nr. 1175 rep., nr. 423 kol., date 08.06.2015, ne te cilen ata jane pale nenshkruese.

**Neni 4: Deklarata dhe garanci te Kolateraldhenesit**

4.1 Kolateraldhenesi dhe Ortaku i tij garantojne Kolateralmarresin se:

(i) Kuotat, objekt i kesaj Marreveshje jane dhe do te jene edhe ne te ardhmen te lira nga cdo peng, barre, e drejte e paleve te treta, apo pretendime te ngritura per kompensim te cilat mund te pengojne apo demtojne Kuotat si dhe se nuk ka parashikime kontraktore te cilat mund te perjashtojne pengun sipas kesaj Marreveshje dhe per aq sa mund te ndikohet nga Kolateraldhenesi, nuk ka dhe nuk do te kete kufizime te tjera te çfaredolloji mbi Kuotat dhe pengun sipas kesaj Marreveshje;

(ii) Ka te gjitha te drejtat dhe autorizimet per te lidhur kete Marreveshje dhe per te permbushur detyrimet sipas kesaj Marreveshje;

(iii) Kjo Marreveshje perben nje detyrim te vlefshem dhe te ekzekutueshem te Kolateralmarresit;

(iv) Lidhja dhe permbushja e kesaj Marreveshjeje nuk vjen ne kundershtim me ndonje detyrim kontraktor apo ligjor te Kolateralmarresit;

(v) Nuk ka asnje pretendim apo procedure gjyqesore apo jashtegjyqesore ne lidhje me Kuotat.

**Neni 5: Ekzekutimi i Marreveshjes**

5.1 Me ndodhjen e nje Rasti Mospermbushjeje (sic parashikohet ne Kontraten e Kredise) ose ne rast te shkeljes apo mospermbushjes se ndonje prej dispozitave te kesaj Marreveshje, Kolateralmarresi, pa cenuar ndonje te drejte ose kompensim qe mund t'i njihet sipas kesaj Marreveshje, Kontrates se Kredise ose ne ligj, ka te drejten te deklaroje menjehere si te pagueshme te gjitha detyrimet e siguruara nga kjo Marreveshje, dhe te mbledhe te gjithe detyrimet se bashku me te gjitha shpenzimet perkatese per realizimin dhe ekzekutimin e kesaj Marreveshjeje.

5.2 Ekzekutimi i Kolateralit i nenshtrohet ekzekutimit te menjehershem nga ana e Kolateralmarresit, pa pasur nevoje per te ndjekur ndonje procedure per ekzekutim te detyrueshem nepermjet gjykates apo permbaruesve gjyqesore.

***Neni 6: Dispozita te perbashketa***

6.1. Palet mund te ndryshojne elementet e kesaj Marreveshjeje vetem me shkrim.

6.2. Mosmarreveshjet e paleve zgjidhen me mirekuptim, ne te kundert kompetente do te jete Gjykata e Rrethit **Tirane.**

6.3. Afati i vlefshmerise se kesaj Marreveshjeje perputhet me afatin e vlefshmerise se Kontrates se Kredise.

6.4. Marreveshja nenshkruhet ne 5 kopje me vlere te njejte.

**KOLATERALMARRES:**

**BKT SH.A – Dega Sauk**

**Perfaqesuar nga:**

**Z. Fatjon HOXHA**

**Zj. Egesta CAUSHI**

**KOLATERALDHENES:**

**Shoqeria "STRAVAJ ENERGY" Sh.p.k**
**Perfaqesuar nga Ortaku i vetem "Edonil Konstruksion" Sh.p.k**

**Perfaqesuar ne nenshkrim nga:**

**Z. Agron MEÇE**

**NOTER/E**

Nr. ______ Tirane, me: 8/6/2015

# VENDIMI I ASAMBLESE SE ORTAKEVE TE SHOQERISE

# "EDONIL KONSTRUKSION" SH.P.K

Sot ne daten 08.06/2015 , u mblodh Asambleja Ortakeve te shoqerise "Edonil Konstruksion" sh.p.k., shoqeri me pergjegjesi te kufizuar, regjistruar ne Qendren Kombetare te Rregjistrimit QKR me date 17/03/2001 me numer unik identifikimit (NIPT) K11519006K me seli ne Kashar, Tirane, e perbere nga ortaku i vetem Z. Agron Mece, qe perfaqeson 100% te pjeseve te shoqerise.

Asambelja e Ortakeve te shoqerise pasi mori ne shqyrtim pikat e rendit te dites:

## VENDOSI:

1- Miratimin si aksioner i vetem me 100% te aksioneve per marrjen e kredise ne shumen **80,000,000(tetedhjete milion) Leke**, nga shoqeria **"Stravaj Energy" sh.p.k** ne Banken Kombetare Tregetare sipas kushteve te percaktuara nga Banka dhe autorizon perdorimin e limitit te aprovuar.

2- Gjithashtu autorizohet Z. Agron Mece, si aksioner I vetem me 100% te aksioneve te shoqerise "Edonil Konstruksion" sh.p.k per te kryer te gjitha procedurat e nevojshme per disbursimin e kredise dhe nenshkruaje cdo dokument tjeter qe do te lidhet midis Bankes Kombetare Tregtare dhe shoqerise "Stravaj Energy" sh.p.k per marrjen e kredise me kushtet e percaktuara ne kontrate.

3- Shoqeria "Edonil Konstruksion" sh.p.k, miraton dhenien e Dorezanise per kredine e marre nga shoqeria "Stravaj Energy" sh.p.k

Gjithashtu "Edonil Konstruksion" sh.p.k si aksioner i vetem me 100% te kuotave, jep miratimin per:

4- Miratimin per lenien peng te 100% te kuotave te shoqerise koncensionare "Stravaj Energy" sh.p.k per garantimin e Huase se marre.

5- Miratimin per barresimin e pajisjeve dhe turbinave te hidrocentralit qe prej castit te mberritjes se tyre.

Gjithashtu "Edonil Konstruksion" sh.p.k si aksioner i vetem me 100% te kuotave, si dhe pronare e pronave si meposhte:

a) **"Njesi**, me siperfaqe **48 m²**, regjistruar me **Nr. Pasurie 306/354-N30,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **36** faqe **14,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -

b) **"Njesi"**, me siperfaqe **48 m²**, regjistruar me **Nr. Pasurie 306/354-N11,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **35** faqe **241,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

c) "**Njesi**", me siperfaqe **30 m²**, regjistruar me **Nr. Pasurie 306/354-N12,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **35** faqe **242,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

d) "**Njesi**", me siperfaqe **58 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/354-N13,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **35** faqe **243,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

e) "**Njesi**", me siperfaqe **48 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/354-N35,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **36** faqe **19,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

f) "**Njesi**", me siperfaqe **582 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/354-N45,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **59** faqe **37,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

g) "**Garazh**", me siperfaqe **820 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/354-G6,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **35** faqe **221,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr, -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

h) "**Njesi**", me siperfaqe **80.4 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/368+1-N5,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **75** faqe **122,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -.

i) "**Njesi**", me siperfaqe **81.5 m²**, regjistruar me **Nr.Pasurie 306/368+1-N9,** e ndodhur ne Zonen Kadastrale nr. **3866,** volumi **75** faqe **126,** me adrese ne **Yzberish Tirane,** e kufizuar nga Veriu me pasurite Nr. -, nga Jugu me pasurine Nr. -, nga Lindja me pasurite Nr. - dhe nga Perendimi me pasurite Nr. -

jep miratimin per rihipotekimin e pronave te mesiperme dhe per limitin e ri shtese ne shumen 80,000,000 (tetedhjete milion) Leke per Stravaj Energy shpk.

Vendimi i mesiperm merret nga Asambleja e Ortakeve, bazuar ne nenet perkates te Statutit te shoqerise, si dhe te ligjit nr. 9901 dt. 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare".

Per sa me siper u lexua ky vendim,i cili pasi lexohet, firmoset me vullnet te lire nga Ortaket.

**Asambleja e Ortakeve**

**Per "Edonil Konstruksion" sh.p.k me ortak**
**Z. Agron MECE**

Agron Mece

EDONIL KONSTRUKSION Sh.p.k. K11510006K TIRANE-ALBANIA